



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2021:082909

Datë: 31.01.2024

Numri i dokumentit: 05263877

C. nr. 381/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË GLLOGOC, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje të trupit gjykues, gjyqtari Astrit Gashi dhe me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Mehmeti, në çështjen juridike të paditësit L.B nga Komuna Gllogoc, kundër të paditurës Komuna Gllogoc-Drejtoria e Arsimit, lidhur me propozimin e përbashkët për Kontest Pune, në seancën e shqyrtimit përgatitor të mbajtur në mungesë të propozuesve të ftuar në mënyrë të rregullt, me datën 26.01.2024 e merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR** propozimi i përbashkët i propozuesve L.B dhe Komuna Gllogoc-Drejtoria e Arsimit për Kontest Pune me marrëveshje i parashtruar në këtë gjykatë me datën 29.04.2021.
- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Gjykata me datë 22.01.2024 ka caktuar seancë për shqyrtim të propozimit të përbashkët për Kontest Pune me marrëveshje të paditësit L.Be dhe te paditurës Komuna Gllogoc-Drejtoria e Arsimit ku të njëjtit nuk kanë prezantuar në këtë seancë të shqyrtimit përgatitor edhe pse kanë pranuar ftesat në mënyrë të rregullt nga kjo gjykatë.

Neni 409 i LPK-së në par. 1 përcakton se “*Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet*”. Ndërsa, Neni 423 par. 3 i LPK-së në par. 1 përcakton se “*Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë,.....*”.

Rrjedhimisht, nga të lartë përshkruarat e në mungesë të propozuesve gjykata konform Nenit 409 par. 1 i LPK-së ka vendosur si në pikën I të dispozitivit me të cilin konsiderohet se është tërhequr propozimi i përbashkët i paditësit L.B dhe te paditurës Komuna Gllogoc-Drejtoria e Arsimit për Kontest pune i parashtruar në këtë gjykatë me datën 29.04.2021.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës si në pikën II të dispozitivit që secila palë ti bart shpenzimet e veta është vendosur në bazë të Nenit 450 të LPK-së.

Duke u bazuar në të lartëcekurat, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
Departamenti i Përgjithshëm, C. nr. 381/21, datë 26.01.2024

Kryetari i Trupit Gjykes
Astrit Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Konform Nenit 206 par. 1 të LPK-së, kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi nëpërmjet kësaj gjykate.